



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040, nenin 18 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 67 shkronja "i" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, me datën 20.11.2019 shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për propozim të anëtarit të komisionit të ankesave ndaj vendimeve të komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Vushtrri

I ftojme të gjitha organizatat joqeveritare përkatësisht shoqërinë civile të Komunës së Vushtrrisë, që të propozojnë nga radhët e tyre një anëtar në komisionin për ankesa ndaj vendimeve të komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës së Vushtrrisë.

Është e preferueshme që kandidati i propozuar për komisionin e ankesave të jetë i caktuar në dakordancë në mes vet OJQ-ve, përkatësisht shoqërisë civile.

Personi i propozuar duhet plotësoj këtë kritere:

- Të jetë banorë rezident i Komunës së Vushtrrisë
- Të ketë diplomë universitare - e preferuar, drejtimi juridik
- Të ketë përvojë të punës në fushën e administratës

Propozimit të kandidatit për anëtarë të komisionit për ankesa duhet bashkëngjitur:

- CV e shkurtër
- Kopje e dokumentit të identifikimit
- Kopjen e diplomës universitare
- Dëshminë për përvojën e punës

Afati i fundit për dorëzim të propozimit është data 25.11.2019

Propozimi me shkrim me dokumentacionin e kërkuar duhet të dorëzohet në zyrën pritëse të Komunës, drejtuar Kryetarit të Komunës, ose, në E-mail: Shkelzen.xhaferi@rks-gov.net.

Vendimin për emërim të anëtarit të propozuar në komisionin e ankesave do ta merr Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë dhe do të publikohet në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Propozimet e arritura pas këtij afati nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo sqarim shtesë, mund të kontaktohet çdo ditë pune zyrtari kontaktues në nr. tel. 044/272577 nga ora 8;30 deri në ora 15;30

 Xhafer Tahiri
Kryetar i Komunës